



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 305, datë 18.06.2024

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga raportore znj. Emona Muçi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu, në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkethehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 3

dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për zbatimin e saj në rastin konkret. Në çdo çështje të shqyrtuar, përpara marrjes në shqyrtim të pretendimeve apo prapësimeve të palëve ndërgjyqëse, gjyqtari {...}, rreshton rrethin e dipozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe më tej vlerëson kërkimet e palëve në raport me parashikimet ligjore përkatëse. Në të drejtën civile, gjyqtari {...}, zgjidh drejt çështjet objekt gjykimi dhe vendimi i dhënë prej tij lihet në fuqi nga gjykatat më të larta, ose nuk ankimohet nga palët (shih dokumentet 1-3 dhe dosjet 1, 2, 3, 4 e 5). Në të drejtën civile gjithashtu, gjyqtari {...}, ka shpallur nivel të mirë njohurish në paditë me objekt si më poshtë: a) Në padinë me objekt: “shpërblim rrjedhur nga marrëdhëniet e punës”, gjyqtari {...}, identifikon saktë ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, (shih vendimin që i përket dokumentit nr. 1). b) Në padinë me objekt “lirim e dorëzim sendi”, gjyqtari {...}, fillimisht verifikon legjitimitimin e palëve ndërgjyqëse bazuar në parashikimet e nenit 296 të K.Civil për padinë e rivendikimit të sendit,..... (shih vendimin e dokumentit nr. 3). c) Në padinë me objekt: “detyrim për dhënie pensioni”, gjyqtari verifikon fillimisht nëse gjykata ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, bazuar në parashikimin e nenit 61 të K.Pr.Civile....(shih vendimin e dosjes nr. 1). ç) Në padinë me objekt: “pavlefshmëri e titullit ekzekutiv dhe anulim gjobe”, gjyqtari {...}, analizon elementët e kësaj padie bazuar në përcaktimet e nenit 609 të K.Pr.Civile, si dhe specifikon dallimet midis kësaj lloji padie me padinë për kundërshtimet e veprimeve përmbare.(shih vendimit e dosjes nr. 2 dhe dosjes nr.3). Njohuri të mira konstatohen tek gjyqtari {...} edhe në zgjidhjen e çështjeve civile me objekt: “njohje pronar”, shih vendimin që i përket dosjes nr. 4. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, kur çmohet se për sqarimin e fakteve duhen njohuri të posaçme, gjyqtari cakton apo thërret ekspertë të fushës për kryerjen e ekspertizës përkatëse dhe vlerëson përmbajtjen e ekspertizës në raport me përmbajtjen e provave të tjera (shih dosjen nr. 4). Në të drejtën procedurale penale, njeh i kushton vëmendje parashikimeve procedurale për caktimin e masave të sigurimit personal, duke zbatuar kërkesat e nenit 228 të K.Pr.Penale, si dhe zbaton saktë parashikimet e nenit 260 të K.Pr.Penale, lidhur me kushtet dhe kriteret për zëvendësimin e masave të sigurimit personal. (shih vendimin e dokumentit nr. 2). Gjithashtu në të drejtën procedurale penale, njeh dhe zbaton si duhet kërkesat e nenit 202 të K.Pr.Penale, për rastet e lejimit të kontrollit të banesës së shtetasit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale (shih vendimin e dosjes nr.5)...”..

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik civil apo penal vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtuara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (civile, familjare, penal themeli, apo kërkesë penale e fazës së hetimit paraprak), rrethanat e fakteve

parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit, pas parashtrimit të disa rrethanave procedurale.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit në të cilën, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues, evidentohen dhe, sipas rastit analizohen, aspekte me natyrë procedurale të cilat konsistojnë në vlerësimin e gjykatës lidhur me (i) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesën e palës për ndryshimin, shtimin apo pakësimin e objektit të padisë,¹ (ii) zhvillimi i gjykimit në mungesë të palëve,² (iii) ecuria procedurale e gjykimit në rastet kur çështja është e kthyer për rigjykim,³ etj. Në një nga vendimet civile burim vlerësimi evidentohet analizë më e thelluar lidhur me elementë të kompetencës lëndore në gjykimin e çështjes, ku në objektin e padisë janë parashtruar tre kërtime, duke referuar në mbështetje të analizës edhe qëndrime të jurisprudencës.⁴

Në vendimin penal burim vlerësimi, rrethanat që lidhen me ecurinë procedurale të gjykimit, analizohen në pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, duke i kushtuar rëndësi vlerësimit të gjykatës lidhur me kërkesën për procedim me gjykim të shkurtuar.⁵

Në vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve te themelit (penale ose civile) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë si objekti i padisë, shkaku ligjor i saj, ndërgjyqësia, procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar në çështjen penale*), zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së fakteve me natyre procedurale, gjyqtari parashtron dhe analizon në mënyrë të detajuar faktet thelbësore të çështjes, duke i paraqitur ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik dhe duke integruar në përmbajtje te faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën. Tipar karakteristik i gjyqtarit {...} është analiza e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Gjithashtu, gjykata në nxjerrjen e faktit juridik, bazohet jo vetëm në provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, por edhe në provat e marra kryesisht nga gjykata tek të tretët konform nenit 223 të K.Pr.Civile,

¹Vendimet nr.1517 (5441), datë 14.12.2016, nr.1076 (2842), datë 23.07.2014, nr.557 (1798), datë 03.05.2016, nr.1497 (4298), datë 29.10.2015 dhe nr.1031 (2722), datë 17.07.2014

²Vendimet nr.135 (314), datë 27.01.2015, nr.1497 (4298), datë 29.10.2015 dhe nr.1528 (4421), datë 27.11.2014

³Vendimi nr.999 (3364), datë 21.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

⁴Vendimi 1076 (2842), datë 23.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

⁵Vendimi nr.526 (2213), datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

apo në kryerjen e akteve ekspertimeve në ato raste kur për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes nevojiten njohuri të posaçme. Në të gjitha vendimet gjyqësore civile konstatohet se gjyqtari tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

-Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtari krijon idenë rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve. Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtari kalon në procesin logjik të përcaktimit të institutit juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje pronësie, mosmarrëveshje që rrjedh nga marrëdhëniet e punës, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, etj.*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjen penale (*vepra penale e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal*) apo natyra e kërkesave penale objekt shqyrtimi (*zëvendësimin e masës së sigurimit apo lejim kontroll banese*).

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, çka përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë konform nenit 467,paragrafi 1 shkronja “a” e K.Pr.Civile. Përpos dispozitave procedurale civile në lidhje me përcaktimin e juridiksionit dhe kompetencës lëndore, gjyqtarit kur është rasti i vjen në ndihmë dhe identifikon për këtë qëllim edhe konkluzionet e arritura nga vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 29.03.2012.⁶ Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes edhe kur nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

⁶Vendimi nr.1518 (4403), datë 26.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

(i) Në vendimet civile gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Punës, Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve organike përkatëse, që kanë lidhje kryesisht me:

- *Dëmshpërblimin që rrjedh nga marrëdhëniet e punës*, ku gjyqtari identifikon dispozitat ligjore materiale: nenin 141 të K.Punës, mbi zgjidhjen e kontratës së punës pa afat; nenin 143 K.Punës, mbi afatin e njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës; nenin 144 K.Punës në lidhje me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës; nenin 155/3 të K.Punës, në lidhje me të drejtën subjektive të punëmarrësit për të kërkuar rikthimin në punë; nenin 145 të K.Punës, në lidhje me institutin e shpërblimit për vjetërsi; nenin 153 të K.Punës, mbi shkaqet e justifikuara të zgjidhjes së marrëdhënies së punës nëse zgjidhja është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe nenet 92 dhe 93 të K.Punës në lidhje me kohëzgjatjen datën e fillimit të pushimeve vjetore, si norma relevante këto për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi në lidhje me të gjitha kërkimet e palës paditëse. Citimi i këtyre dispozitave ligjore materiale si ligj i zbatueshëm bëhet nga ana e gjyqtarit jo vetëm duke iu referuar pretendimit të palës paditëse mbi kërkimin objekt gjykimi, por duke iu referuar cilësimit të saktë të faktit juridik civil që ka bërë gjyqtari mbi bazën e provave objekt gjykimi.⁷
- *Padinë reale të pushimit të cenimit të pronësisë* duke identifikuar për këtë qëllim normën relevante, nenin 302 të K.Civil lidhur dy elementët e padisë mohuese, legjitimitetin aktiv dhe atë pasiv. Në lidhje me kërkimin për njohjen e pavërtetësisë së pjeshëm të dokumentit, gjyqtari referon dispozitën e përgjithshme të ngritjes së padisë, neni 32/c i K.Pr.Civile, në lidhje me legjitimin e palës paditëse për të kërkuar njohjen e pavërtetësisë ose vërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për të.⁸
- *Padinë reale të rivendikimit* duke identifikuar për këtë qëllim jo vetëm normën relevante për zgjidhjen e çështjes, nenin 296 të K.Civil, por njëkohësisht edhe dispozitat e tjera materiale civile që kanë lidhje me normën kryesore, si ato që kanë lidhje me posedimin e ligjshëm apo të paligjshëm, nenet 304 e 305 të K.Civil.⁹
- *Pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv të faturave të energjisë elektrike*, ku gjyqtari identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale, nenin 609 të K.Pr.Civile, në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe po kështu ligjin e posaçëm nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi ligjshmërinë apo jo të faturimit të energjisë elektrike të abonentit.¹⁰
- *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*, gjyqtari identifikon dispozitat e Kodit të Familjes që gjejnë zbatim lidhur me zgjidhjen e martesës dhe pasojat e saj në raport me bashkëshortët, si dhe dispozitat në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijët e mitur, duke identifikuar në shërbim të analizës ligjore nenet 2, 132, 146, 158, 159, 161, 201, 215, 216 dhe 220 të Kodit të Familjes. Krahas dispozitave të Kodit të Familjes, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”, në lidhje me përcaktimin dhe më pas interpretimit e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.¹¹
- Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si më zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht citimi i dispozitës procedurale civile që ka lidhje me padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv (*neni 609 i K.Pr.Civile*) është identifikuar si ligj i zbatueshëm material në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel dhe jo si dispozita për zgjidhjen e kërkesave procedurale në funksion të gjykimit. Ndërkohë në raste të tjera konstatohet identifikimi i dispozitave procedurale

⁷Vendimet nr.1528 (4421), datë 27.11.2014 dhe nr. 1031 (2722), datë 17.07.2014

⁸Vendimi nr.1076 (2842), datë 23.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

⁹Vendimi nr.565 (1815), datë 03.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

¹⁰Vendimet nr.365 (17.03.2014), datë 17.03.2014 dhe nr.1497 (4298), datë 29.10.2015

¹¹Vendimi nr.1056 (2782), datë 01.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

- në lidhje me vendimmarrjen mbi kërkesat për pjesëmarrjen e personave të tretë në procesin civil, si ndërrhyrës kryesor (*neni 189 i K.Pr.Civile*),¹² për shtimin, ndryshimin apo pakësimin e objektit të padisë (*nenet 125 e 185 i K.Pr.Civile*),¹³ lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes civile (*neni 6 të K.Pr.Civile*),¹⁴ lidhur me detyrimin e gjykatës për tu shprehur për gjithçka që kërkohet, si dhe detyrimin e saj për të bërë një cilësim të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët (*neni 16 i K.Pr.Civile*),¹⁵ lidhur me fuqinë e plotë provuese të akteve zyrtare të dala nga nëpunësit e shtetit apo personat që ushtrojnë një veprimtari publike (*neni 253 i K.Pr.Civile*)¹⁶ lidhur me disponimin për pushimin e gjykimit për një pjesë të kërkimeve, për shkak të kërkesës të paditësit për heqje dorë nga gjykimi i tyre (*nenet 201 e 299/b të K.Pr.Civile*) etj. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, gjykata ka disponuar lidhur me kërkesat procedurale në përputhje me faktin, provat dhe dispozitën relevante procedurale përkatëse. Po kështu, citohen dispozitat procedurale civile, lidhur me vlerësimin kryesisht të çështjeve të juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes civile objekt gjykimi (*nenet 36/1, 41, 51, 43, 45 të K.Pr.Civile*). Në një çështje gjyqtari ka referuar edhe në ligjin e posaçëm që përcakton çështjen e kompetencës lëndore, duke referuar përkatësisht *nenet 7/a/b dhe 17/ç të ligjit nr. 49/2012* “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.¹⁷

(ii) **Në vendimin penale**, gjyqtari identifikon dispozitën materiale penale në lidhje me akuzën e “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, *neni 291 të K.Penal*, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit. Në analizën e anës objektive të figurës së veprës penale të “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt” pa leje drejtimi, gjyqtari i është referuar edhe *neneve 53 dhe 115 të ligjit organik nr. 8378, datë 22.07.1998, i ndryshuar (Kodi Rrugor)*. Gjithashtu, përveç dispozitës së pjesës së posaçme, gjyqtari referohet edhe në dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht *nenit 47-50 të K.Penal* në lidhje me kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, *nenin 63 të K.Penal* në lidhje me një nga alternativat e dënimit me burgim, atë të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, në vendimin me objekt zëvendësim mase sigurimi, gjyqtari identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës që i bëhet kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” të caktuar ndaj personi nën hetim, me një masë tjetër më të lehtë (*nenin 230, 260/2 të K.Pr.Penale*) dhe vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228/3 dhe 229 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kriteret e caktimit të masave të sigurimit. Krahas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe akte ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, dhe konkretisht *nenet 3 dhe 5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*, në lidhje me të drejtën e çdo individi për të mos iu nënshtruar “torturës”, “trajtimi çnjerëzor” apo “denigrues”.

¹²Vendimi nr.999 (3364), datë 21.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

¹³Vendimet nr.1497 (4298), datë 29.10.2015, nr.1517 (5441), datë 14.12.2016

¹⁴Vendimi nr.1031 (2722), datë 17.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

¹⁵Vendimi nr.1518 (4403), datë 26.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

¹⁶Vendimi nr.565 (1815), datë 03.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

¹⁷Vendimi nr.1518 (4403), datë 26.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

Gjithashtu, gjyqtari në vendimin penal të themelit identifikon dispozitat procedurale penale në lidhje me shuarjen e masës së sigurimit për shkak të pezullimit të dënimit të caktuar (*neni 261/b i K.Pr.Penale*), pasojat e shuarjes së masës së sigurimit (*neni 262 i K.Pr.Penale*,) disponimin mbi masat e sigurimit (*neni 389 i K.Pr.Penale*), si dhe lidhur me shpenzimet procedurale (*nenet 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale*).

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Identifikimi dhe përcaktimi nga gjyqtari, në mënyrë të qartë i faktit juridik që përbën objektin e gjykimit, orienton mënyrën e paraqitjes së fakteve, analizën e provave dhe analizën ligjore të çështjes në vijim të arsyetimit të vendimit, analizë e cila është e ndryshme në bazë të objektit të gjykimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit gjyqtari {...}, ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në të drejtën civile gjithashtu, gjyqtari {...}, ka shpalosur nivel të mirë njohurish në paditë me objekt si më poshtë: a) Në padinë me objekt: “shpërblim rrjedhur*

nga marrëdhëniet e punës”, gjyqtari {...}, identifikon saktë ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, analizon nëse është respektuar nga punëdhënësi procedura dhe afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, arsyeton nëse jemi para zgjidhjes së zakonshme apo të menjëhershme të kontratës së punës dhe në zgjidhjen me efekt të menjëhershëm analizon shkaqet nëse janë të arsyeshme apo të pajustificuara, referon në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë për raste të ngjashme, jep përgjigje shteruese për pretendimet dhe prapësimet kryesore të palëve ndërgjyqëse duke argumentuar cilat janë të bazuara dhe cilat të pabazuara ligjërisht etj. (shih vendimin që i përket dokumentit nr. 1). b) Në padinë me objekt “lirim e dorëzim sendi”, gjyqtari {...}, fillimisht verifikon legjitimitimin e palëve ndërgjyqëse bazuar në parashikimet e nenit 296 të K.Civil për padinë e rivendikimit të sendit, analizon elementët e kësaj lloji padie bazuar në parashikimin ligjor, por edhe sipas doktrinës juridike, arsyeton nëse posedimi i sendit nga i padituri është me titull apo pa titull dhe nëse titulli është i ligjshëm apo i paligjshëm, si dhe analizon mënyrën e fitimit të pronësisë së sendit nga paditësi. Jepet përgjigje e argumentuar për pretendimet e palës paditëse dhe për prapësimet e palës së paditur, duke vlerësuar se cilat janë të bazuara dhe cilat jo, etj. (shih vendimin e dokumentit nr. 3). c) Në padinë me objekt: “detyrim për dhënie pensioni”, gjyqtari verifikon fillimisht nëse gjykata ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, bazuar në parashikimin e nenit 61 të K.Pr.Civile. Vlerësohet se bazuar në parashikimet e neneve 7/a e 7/b të Ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative.....”, si dhe bazuar në vendimin unifikues nr. 3. Dt. 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë, mosmarrëveshja objekt gjykimi është në kompetencë lëndore të gjykatës administrative. Prandaj vendoset shpallja e moskompetencës lëndore dhe dërgimi i dosjes bashkë me aktet gjykatës kompetente. (shih vendimin e dosjes nr. 1). ç) Në padinë me objekt: “pavlefshmëri e titullit ekzekutiv dhe anullim gjobe”, gjyqtari {...}, analizon elementët e kësaj padie bazuar në përcaktimet e nenit 609 të K.Pr.Civile, si dhe specifikon dallimet midis kësaj lloji padie me padinë për kundërshtimet e veprimeve përmbajtore. Analizohet ligjshmëria e titullit ekzekutiv bazuar në parashikimet e ligjit specifik (Ligjit Nr. 9072, dt. 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë i ndryshuar më vonë”, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij të nxjerra nga organi kompetent shtetëror ERE. Ndër të tjera, evidentohet se barra e provës për të provuar sasinë e energjisë elektrike të konsumuar i takon palës së paditur (Cez Shpërndarje) ep.(shih vendimit e dosjes nr. 2 dhe dosjes nr.3). Njohuri të mira konstatohen tek gjyqtari {...} edhe në zgjidhjen e çështjeve civile me objekt: “njohje pronar”, shih vendimin që i përket dosjes nr. 4. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, kur çmohet se për sqarimin e fakteve duhen njohuri të posaçme, gjyqtari cakton apo thërret ekspertë të fushës për kryerjen e ekspertizës përkatëse dhe vlerëson përmbajtjen e ekspertizës në raport me përmbajtjen e provave të tjera (shih dosjen nr. 4). Në të drejtën procedurale penale, njeh i kushton vëmendje parashikimeve procedurale për caktimin e masave të sigurimit personal, duke zbatuar kërkesat e nenit 228 të K.Pr.Penale, si dhe zbaton saktë parashikimet e nenit 260 të K.Pr.Penale, lidhur me kushtet dhe kriteret për zëvendësimin e masave të sigurimit personal. (shih vendimin e dokumentit nr. 2). Gjithashtu në të drejtën procedurale penale, njeh dhe zbaton si duhet kërkesat e nenit 202 të K.Pr.Penale, për rastet e lejimit të kontrollit të banesës së shtetasit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale (shih vendimin e dosjes nr.5) Nga ana tjetër, ndër 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar tre prej tyre dhe në tre rastet, vendimi i dhënë nga gjyqtari {...} është lënë plotësisht në fuqi apo nuk është

cenuar nga Gjykata e Apelit (shih dosjet 2,3 dhe 4). Vendimet që i përkasin dosjeve nr. 1 dhe nr. 5, kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët. Në lidhje me vendimet që ju përkasin tre dokumenteve të përzgjedhura nga vet subjekti i rivlerësimit, vendimet e dokumenteve 1 dhe 2 janë ankimuar dhe janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, ndërsa për vendimin e dokumentit nr. 3 nuk kemi të dhëna nëse ankimuar në gjykatat më të larta”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), por edhe interpretimin gramatikor apo sistematik të normave dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzion në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

(i) Në vendimet civile: Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik/abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari:

- Interpreton në mënyrë literale nenin 296 të K.Civil për të përcaktuar se kush janë kushtet dhe kriteret e padisë reale të rivendikimit, e duke i analizuar secilin nga elementet ligjorë të kësaj padie reale (*ekzistenca e sendit, qenien pronar- legjitimimi aktiv dhe posedimin e paligjshëm – legjitimimi pasiv*) në përputhje me provat e shqyrtuara, arrin në konkluzionin logjik të pranimet pjesërisht të padisë.¹⁸
- Interpreton në mënyrë literale nenin 302 të K.Civil për të përcaktuar se kush janë kushtet dhe kriteret e padisë mohuese të pushimit të cenimit të pronësisë, e duke i analizuar secilin nga elementet ligjorë të kësaj padie mohuese (*qenien pronar –legjitimi aktiv; cenim i pronësisë nga i padituri - legjitimimi pasiv*) apo edhe elementët e cenimit të pronësisë nga i padituri (*paligjshmëria e veprimt, vazhdueshmëria dhe aktualiteti*) në përputhje me provat e shqyrtuara, arrin në konkluzionin logjik të rrëzimit të këtij kërkim për shkak të mungesës së legjitimit pasiv.¹⁹
- Interpreton në mënyrë literale nenin 341 të K.Civil për të përcaktuar dy kushtet e domosdoshme që trashëgimtarit ligjorë të përgjigjet civilisht për detyrimet që rëndojnë në pasurinë trashëgimore.²⁰
- Merr në analizë një nga tre mjetet e mbrojtjes në fazën e ekzekutimit, duke interpretuar nenin 609 të K.Pr.Civile, në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, si një nga paditët që mund të ngrihet, edhe

¹⁸Vendimi nr.565 (1815), datë 03.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

¹⁹Vendimi nr.1076 (2842), datë 23.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

²⁰Vendimi nr.1517 (5441), datë 14.12.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

- kur nuk ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm i tij. Në këtë vendim gjyqtari interpreton edhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme në lidhje me konceptet “*energji e pamatur*”, “*dëm ekonomik*”, “*entitet i caktuar me ligj*”, në funksion të analizës se fatura e energjisë elektrike është emërtuar në mënyrë të paligjshme nga pala e paditur, e në kundërshtim me ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për spektrorin e energjisë elektrike” dhe si pasojë është e pavlefshme si titull ekzekutiv.²¹
- Analizon dispozitat e Kushtetutës (*nenin 53*) dhe KEDNJ (*nenet 8 dhe 12*), si dhe dispozitat e Kodit të Familjes (*nenet 1, 123, 132 e vijues të K. Familjes*) në lidhje me *institutin e martesës*, parimet mbi të cilat mbështetet martesja, rastet e zgjidhjes së saj, shkaqet ligjore, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke analizuar për këtë qëllim edhe dispozita të akteve ndërkombëtare dhe të K.Familjes në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, përgjegjësinë prindërore, duke evidentuar kuptimin e këtij instituti dhe karakteristikat e tij (*nenet 3/1, 146, 215, 216, 220, 155 dhe 157 të K. Familjes*), detyrimin për ushqim dhe karakterin e ndryshueshëm të këtij detyrimi (*nenet 161, 158, 159, 201/2, 207 të K. Familjes*), etj.²²
- Interpreton dispozitat e Kodit të Punës në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës dhe pasojat e saj për punëdhënësin dhe punëmarrësin. Konkretisht, gjyqtari interpreton nenet 141 dhe 143 të K.Punës lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kontratës, interpretim i cili bëhet duke pasur në vëmendje vendimin unifikues nr.14, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, gjyqtari interpreton nenin 155/3 të K.Punës lidhur me kushtet kumulative që duhet të plotësohen për të qene përpara të drejtës subjektive të punëmarrësit për të kërkuar gjyqësisht rikthimin në punë. Merr në analizë nenet 143 dhe 153 të K.Punës në lidhje me të drejtën e punëmarrësit për t’u dëmshpërblyer në lidhje me mosrespektimin e afatit të njoftimit, në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Analizon detyrimin e punëdhënësin për shpërbllimin e dëmit për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, referuar nenit 144 të K. Punës. Interpreton nenin 153 të K.Punës në lidhje me kushtet që duhen të plotësohen që të pranohet ekzistenca e një motivi justifikues për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme, për të konkluduar se marrëdhënia e punës është zgjidhur pa shkaqe të justifikuar. Më pas gjyqtari ndalet në interpretimin e neneve 155 të Kodit të Punës, lidhur me kriteret që duhet të mbajë gjykata në përcaktimin e masës së dëmshpërbllimit. Në mbështetje të interpretimit që gjyqtari i bën dispozitës ligjore materiale, referon edhe praktikën gjyqësore relevante (*qëndrimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 555, datë 04.12.2012*).²³

(ii) Në vendimin penale të analizuar, gjyqtari interpreton normën përkatëse të K.Penal në mënyrë abstrakte (neni 291 i K.Penal), duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar në të katër elementët e figurës së veprës penale të “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Përpos interpretimit të dispozitës materiale penale në lidhje me kualifikimin e veprës penale për të cilin akuzohet i pandehuri, evidentohet edhe interpretimi i dispozitës të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me aplikimin e një nga alternativat e dënimit, atë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit dhe detyrimin për të kryer një punë me interes publik (*neni 63 të K.Penal*), duke u ndalur në kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të përfituar këtë lloj dënimi alternativ.²⁴

- ***Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale***

Gjyqtari në varësi të natyrës së çështjes, si dhe qëndrimit të tij për aspekte procedurale të çështjes, ka interpretuar në përputhje me rrethanat e faktit apo ato procedurale dispozita të

²¹Vendimet nr.365 (955), datë 17.03.2014 dhe nr.1497 (4298), datë 29.10.2015

²²Vendimi nr.1056 (2782), datë 01.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

²³Vendimet nr.1528 (4421), datë 27.11.2014 dhe nr.1031 (2722), datë 17.07.2014

²⁴Vendimi nr.526 (2213), datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

caktuara të Kodit të Procedurës Civile apo Kodit të Procedurës Penale, duke dhënë kuptimin e tyre referuar qëllimit të dispozitës dhe më pas duke e aplikuar mbi faktin/rrethanën konkrete mbi të cilin ajo gjen zbatim. Konkretisht, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, sa i përket interpretimit të ligjit procedural civil apo penale, rezulton se:

- Në vendimin me objekt “Zëvendësim i mase sigurimi,” gjyqtari bën interpretim teorik të dispozitës procedurale, neni 260 i K.Pr.Penale, duke dhënë kuptimin e saj, si dhe duke përcaktuar kushtet dhe kriteret ligjore për aplikimin e saj. Interpretimi në nivel teorik i dispozitës mbështetet me referimin edhe të qëndrimit të GJEDNJ.²⁵
 - Interpreton nenet 402/4 dhe 404 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar sa i përket plotësimit të kushteve ligjore të këtij neni, me pasojë pranimin e kërkesës.²⁶
 - Në çështjen civile ku kompetenca lëndore është analizuar kryesisht në mënyrë më të zgjeruar, gjyqtari interpreton nenet 61 dhe 62 të K.Pr.Civile në lidhje edhe me nenin 7/ç të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në funksion të shpalljes së mos kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes,²⁷ etj.
- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante**

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- *Dëmshtëpërblimin që rrjedh nga marrëdhëniet e punës*,²⁸ konstatohet se nga ana e gjyqtarit në arsyetim është cituar dhe zbatuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjes vendimi unifikues nr. 19, datë 15.11.2007, por edhe vendimet nr. 140/2010, nr. 8/2010, nr.420/2010, nr.193/2011, nr.24/2010, nr.450/2010, nr.478/2011, nr.240/2012 dhe nr.555/2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Në vendimin me objekt zgjidhje martesë, gjyqtari referon qëndrimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.357, datë 11.09.2008, në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.²⁹
- *Padia e kërkimit të sendit*, gjyqtari citon vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.1251/2003, nr.1103/2005, nr.1182/2005, nr.610/2006, nr.51/2007, nr.426/2007 etj., lidhur me detyrimin e gjykatës për të analizuar të gjithë elementet e karakteristikë të kësaj padie.³⁰
- *Gjykimin e shkurtuar*, gjyqtari referon dhe zbaton në pranimin e kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Vendimin nr.7, datë 14.10.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me kompetencën e gjykatës për të disponuar mbi shuarjen e masës së sigurimit.³¹
- *Zëvendësimin e masave të sigurimit*, gjyqtari referon praktikën e GJEDNJ (*por pa referuar vendimin konkret*) në funksion të vlerësimit që i bëhet nevojave të sigurimit që përligjin caktimin e nja masë sigurimi dhe matjen e shkallës së këtyre nevojave,³² etj.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

²⁵Vendimi nr.260 (1301), datë 26.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

²⁶Vendimi nr.526 (2213), datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

²⁷Vendimi nr.1518 (4403), datë 26.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

²⁸Vendimi nr.1031 (2722), datë 17.07.2014 dhe vendimi nr. 1528 (4421), datë 27.11.2014

²⁹Vendimi nr.1056 (2782), datë 01.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

³⁰Vendimi nr.565 (1815), datë 03.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

³¹Vendimi nr.526 (2213), datë 4.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

³²Vendimi nr.260 (1301), datë 26.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

Nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtari njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e interesit më të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim neni 2 të K.Familjes, dispozita të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”. Në kuadër të analizës lidhur me të drejtën për martesë, të drejtën për jetë private dhe familjare, gjyqtari referon parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në lidhjen e martesës.
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor* nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile (*nenet 14 dhe 16 të K.Pr.Civile*).
- *Parimin procedural të barrës së provës*, në funksion të vlerësimit të fakteve që shërbejnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
- *Parimin e mirëbesimit* mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në kuadër të analizës lidhur me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës, etj.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Respektohen rregullat e drejtshkkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor....”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore, referuar gjuhës së përdorur në shkrim, janë të qarta dhe të kuptueshme edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton se në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike. Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine,³³ por gjithmonë kuptimi i tyre jepet në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin natyrshëm nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Spikat aftësia e gjyqtarit në drejtim të koncizitetit të përshkrimit të fakteve të çështjes, ruajtjes së rendit kronologjik të tyre, pa përsëritje, çka krijon një panoramë të qartë të konfliktit që ai ka për zgjidhje, apo të fakteve mbi të cilat janë ngritur akuzat në gjykim. Referimi i përmbajtjes së provave është i barazpeshuar dhe po kështu edhe pretendimet e palëve. Nëpërmjet pasqyrimit të këtyre të fundit evidentohen lehtësisht çështjet që shtrohen për zgjidhje, e që gjyqtari duhet t'iu japë përgjigje në vendimin gjyqësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

³³Për shembull: “*ratio legis*”, “*formulae praeiudiciales*” “*provocatio ad agendum*” apo “*impositip silenti*”, etj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet me argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumentave ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*), etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...*Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari...*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë në përmblyllje procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, përgjithësisht të identifikuar me

tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të listuar formalisht me tituj, duke orientuar qartë lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje:

- (i) *procedura*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes, si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin pranimit të ndërhyrësit kryesor³⁴ apo kërkesës për pakësim, ndryshimin, apo shtimin e objektit të padisë,³⁵ shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar,³⁶ ezaurimin e procedurës së pajtimit në çështjet me objekt zgjidhje martesë,³⁷ etj.
- (ii) *faktet e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave* të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave.
- (iii) *analizën ose vlerësimin ligjor* të gjykatës lidhur me çështjen. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale, ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Në pjesën tjetër të vendimeve civile, gjyqtari organizon pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit duke ndjekur kryesisht metodën e dhënies së konkluzionit të tij mbi bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt padie, për të vijuar më pas me shtjellimin dhe renditjen e argumenteve në mbështetje të këtij konkluzioni.³⁸ Ndërkohë, në çështjen penale të themelit, analiza ligjore organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zberthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përqasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit, dhe më tej me analizën lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit.

³⁴Vendimi nr.999 (3364), datë 21.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

³⁵Vendimet nr.557 (1798), datë 03.05.2016, nr.1076 (2842), datë 23.07.2016, nr.1517 (5441), datë 14.12.2016, nr.1031 (2722), datë 17.07.2014

³⁶Vendimi nr.526 (2213), datë 24.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

³⁷Vendimi nr.1056 (2782), datë 01.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

³⁸Vendimet nr.999 (21.07.2016), datë 21.07.2016, nr.135 (314), datë 27.01.2014, nr.1497 (4298), datë 29.10.2015, nr.365 (955), datë 17.03.2014

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor*), apo mënyrën e disponimit në çështjet e fazës së hetimit paraprak (*për pranimin e kërkesës me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit apo të lejimit të kontrollit të banesës*), dënimit dhe masën e dënimit, pezullimin e ekzekutimit të dënimit, disponimi mbi masën e sigurimit, si dhe shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimin penal themelit, etj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.³⁹

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

³⁹Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiou vs Greqisë*, datë 16.12.1992, fq.33.

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit Gjyqtari {...}, ka shfaqur aftësi shumë të mira duke i kushtuar mjaft vëmendje arsytimit ligjor të vendimeve të dhëna prej tij. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Jo vetëm citohet përmbajtja e provave, por ato analizohen dhe krahasohen me njëra-tjetrën në funksion të vërtetësisë së fakteve që ato përmbajnë. Rëndësi në analizë, vlerësim, çmim të provave i kushtohet, si atyre të fakteve të cilat konsiderohen të bazuara ashtu edhe atyre fakteve, të cilat gjyqtari i cilëson si të pambështetura në prova. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, si atyre që vlerësohen si të bazuara ligjërisht, ashtu edhe atyre që rrëzohen si të pambështetura në ligj, duke treguar se gjyqtari ka qenë i vëmendshëm ndaj kërkesave të tyre”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për secilin kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime, lidhur me:

- shpërblimit të dëmit në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke analizuar në mënyrë të posaçme afatet e zgjidhjes së kontratës, shkaqet e justifikuara, pasojat që vijnë nga mosrespektimi i dispozitave ligjore nga ana e punëdhënësit. Po kështu, gjyqtari ndalet edhe në analizën juridike të kërimit të palës paditëse për pavlefshmëri të aktit me të cilin është deklaruar zgjidhja e kësaj marrëdhënie dhe kërimit për kthimin në vendin e mëparshëm të punës;⁴⁰
- institutit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke u ndaluar në këtë drejtim në pasojat në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe ato me karakter material, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës;⁴¹

⁴⁰Vendimi nr.1528 (4421), datë 27.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

⁴¹Vendimi nr. 1056 (2782), datë 01.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

- padinë e rivendikimit, duke zbërthyer dhe analizuar elementët që qëndrojnë në themel të saj;⁴²
- mjetet e posaçme të mbrojtjes gjatë fazës së ekzekutimit duke analizuar dispozitën procedurale që parashikon padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv;⁴³
- analizën e katër elementët e figurës së veprës penale, në arritjen e konkluzionit mbi përgjegjësinë penale të autorit. Në vendimin penal konstatohet se gjyqtari analizon *qëllimin* e dënimit dhe pasi analizon dispozitën përkatëse materiale mbi individualizimin e dënimit, ndalet në mënyrë të veçantë tek çdo rrethanë lehtësuese për të pandehurin, analizon dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit si alternativë dënimi, duke analizuar kriteret ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për aplikimin e kësaj alternative.⁴⁴

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.*), duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsyetimit (*por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret*), pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Argumentimi për çdo konkluzion të arritur mbi çështjet e analizuara, si në aspektin procedural, ashtu edhe në lidhje me themelin, ka në bazë një analizë të detajuar dhe të integruar të provave, interpretim të ligjit të zbatueshëm dhe aplikimin e tij mbi faktin konkret, duke evidentuar qartë marrëdhënien shkak-pasojë dhe mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

⁴²Vendimi nr.565 (1815), datë 03.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

⁴³Vendimet nr.365 (955), datë 17.03.2014 dhe nr.1497 (4298), datë 29.10.2015

⁴⁴Vendim nr.526 (2213), datë 24.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në katër raste, është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 5)...”.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari dhe dosjes së administruar nga Komisioni për shkak të ankesave.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, 1 (një) çështje të administruar për shkak të ankesave dhe 1 (një) çështje të referuar për efekt vlerësimi, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit.

Konkretisht:

- Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*Lejimi kontrolli të banesës*), parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 24 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, si çështje me karakter të ngutshëm. Referuar vendimit nr.948 (4501), datë 03.12.2014, rezulton se kërkesa për lejimi

kontrolli është regjistruar në gjykatë, në datën 02.12.2014, ora 13:12 dhe ka përfunduar në datën 03.12.2014, ora 12:30, duke përfunduar ***brenda afatit ligjor prej 24 orësh.***

- Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (zëvendësimin e masës së sigurimit), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 5 ditor nga momenti i depozitimit në gjykatë. Referuar vendimit nr. 260 (1301), datë 26.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezultoi se kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit ka si datë regjistrimi datën 23.03.2015 dhe datë vendimi datën 26.03.2015. ***Rezultoni që është respektuar afati 5 ditor i parashikuar në nenin 260/4 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.***

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuar më sipër në të cilat afati ligjor i gjykimit është respektuar dhe prezumimit se në mungesë të të dhënave të tjera që mund të ndikojnë në vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi, aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues është e lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të gjitha të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultoi se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuar për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtari pikëzohet 15 pikë pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej afatit ligjor, është 0%.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...}, ka qenë në intervale kohore nga: 1 ditë (shih dosjen 5); 28 ditë (shih dosjen 1); 26 ditë (shih dosjen 2); 6 muaj e 27 ditë përfshirë edhe afatin e lejes vjetore (6 muaj po t'i zbritet afati i lejes vjetore) (shih dosjen 3) dhe 7 muaj e 12 ditë (shih dosjen 4). Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në katër raste, është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 5). Në një rast që i përket dosjes nr.4, që i përket një gjykimi themeli dhe me palë kundërshtarë, afati standard i gjykimit është tejkaluar me 1

muaj e 12 ditë. Shkaqet e zvarritjes së gjykimit në këtë rast janë pasqyruar llësisht në analizën që i përket dosjes nr. 4 dhe zvarritja nuk ka ardhur për faj të gjyqtarit, por për shkaqe që lidhen me palët ndërgjyqëse (shih argumentat e dhëna nga ne në analizën e dosjes nr. 4). Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, në dy prej vendimeve të prezantuara është respektuar afati standard i gjykimit ose afati ligjor (shih dokumentet 1 e 2), ndërsa në dokumentin 3 që përfaqëson një gjykim civil me palë kundërshtare, afati standard i gjykimit është shkelur...”

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10⁴⁵ çështjeve të për zgjedhura me short, 2⁴⁶ vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari, 1 çështjeje e administruar nga Komisioni për shkak të ankesave dhe 1 çështjeje të referuar për efekt vlerësimi nga ish-KLD. Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara, gjykimi jo gjithmonë ka përfunduar brenda standardeve minimale kohore, ku referuar Vendimit nr.261/2 të KLD, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

Çështje penale të kategorisë krime:

- (i) Çështja penale me nr.723 (58345-00969-51-16) regj. them., datë regjistrimi 27.04.2016, me të pandehur M.R., akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Drejtimit i automjetit në mënyrë të parregullt*”, parashikuara nga neni 291 i K.Penal, i është caktuar gjyqtarit me short në datën 28.04.2016 dhe ka përfunduar me vendimin nr.526 (2213), datë 24.05.2016. Referuar të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për 26 ditë, **pra brenda afati 9 muajor të standardit minimal kohor për penale (për veprat penale të kategorisë krime).**

Çështje familjare me palë kundërshtare:

- (i) Çështja civile nr.1218 (0775) regj. them., datë 14.04.2015, me objekt “*Zgjidhje martesë*”, i është caktuar gjyqtarit me short po në datën 14.04.2015 dhe ka përfunduar me vendimin nr.1056 (2782), datë 09.07.2015. Referuar të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për 2 muaj e 25 ditë, **pra brenda afati 4 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare.**

Çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare:

- (i) Çështja civile nr.2010 (21236-02391-51-14) regj. them., datë 29.10.2014, me objekt të padisë “*Detyrimin e palës së paditur t’i jap pension pleqërie...*” i është caktuar gjyqtarit me short në datën 30.10.2014 dhe ka përfunduar me vendimin nr.1518 (4403), datë 26.11.2014. Referuar të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për 27 ditë, **pra brenda afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**
- (ii) Çështja civile nr.783 (21282-00370-51-14) regj. them., datë 20.02.2014, me objekt të padisë “*Pavlefshmëri titulli ekzekutiv...*” i është caktuar gjyqtarit me short në datën

⁴⁵Nuk përfshihet çështja me nr.948 (4501) vendimi, datë 03.12.2014 pasi është çështje me afat ligjor

⁴⁶Nuk përfshihet vendimi i zgjedhur me nr. 260 (1301), datë 26.03.2015 për shkak se është çështje me afat ligjor

20.02.2014 dhe ka përfunduar me vendimin nr.365 (955), datë 17.03.2014. Referuar të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për 25 ditë, ***pra brenda afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***

- (iii) Çështja civile nr.1162 (21290-00695-51-15) regj. them., datë 02.04.2015, me objekt të padisë “*Anulim titullit ekzekutiv...*” i është caktuar gjyqtarit me short në datën 02.04.2015 dhe ka përfunduar me vendimin nr.1497 (4298), datë 29.10.2015. Referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 6 muaj e 27 ditë. Çështja i është caktuar gjyqtarit me short në muajin prill të vitit 2015 dhe ka përfunduar në muajin tetor të po atij viti. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore të vitit 2014 (30 ditë),⁴⁷ kjo çështje do të kishte përfunduar për 5 muaj e 27 ditë, ***pra brenda afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje tregtare dhe e tillë do të konsiderohet.***
- (iv) Çështja civile nr.27/2195 (11111-02317-51-15) regj. them., datë 09.11.2015, me objekt të padisë “*Detyrim njohje pronar...*” i është caktuar gjyqtarit me short në datën 09.11.2015 dhe ka përfunduar me vendimin nr.999 (3364), datë 21.07.2016. Referuar të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për 8 muaj e 12 ditë, ***pra tej afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (v) Çështja civile nr.1109 (21244-00884-51-14) regj. them., me objekt të padisë “*Padi marrëdhënie pune...*” sipas të dhënave në vendim nr. 1031 (2722), rezulton se data e regjistrimit është 23.04.2014 dhe data e përfundimit të çështjes është 17.07.2014. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për një afat prej 2 muaj e 24 ditë, ***pra brenda afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (vi) Çështja civile nr.73/965 (11115-00403-51-15) regj. them., me objekt të padisë “*Lirim dhe dorëzim sendi...*” sipas të dhënave në vendim nr. 565 (1815), rezulton se data e regjistrimit është 23.02.2015 dhe data e përfundimit të çështjes është 03.05.2016. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për një afat prej 1 vit, 2 muaj e 10 ditë, ***pra tej afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (vii) Çështja civile nr.719 (21256-00280-51-14) regj. them., datë 10.02.2014, me objekt të padisë “*Pushim cenimi në pronësi...*” i është caktuar gjyqtarit me short në datën 10.02.2014 dhe ka përfunduar me vendimin nr.1076 (2842), datë 23.07.2014. Referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 5 muaj e 13 ditë, ***pra brenda afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (viii) Çështja civile nr.883 (21264-00532-51-14) regj. them., datë 10.03.2014, me objekt të padisë “*Padi marrëdhënie pune...*” i është caktuar gjyqtarit me short po në datën 10.03.2014 dhe ka përfunduar me vendimin nr.1528 (4421), datë 27.11.2014. Referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 8 muaj e 17 ditë, ***pra tej afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***

⁴⁷Neni 24/2 i ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes përcaktonte se “*Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht...*”.

- (ix) Çështja civile nr.167/1789 (11217-02031-51-14) regj. them., datë 21.09.2014, me objekt të padisë “*Detyrimin e të paditurve të përfundojnë detyrimin kontraktual dhe detyrim njohje bashkëpronar...*” i është caktuar gjyqtarit me short në datën 22.09.2014 dhe ka përfunduar me vendimin nr.135 (314), datë 27.01.2015. Referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 4 muaj e 5 ditë, ***pra brenda afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (x) Çështja civile nr.743 (11232-00249-51-16) regj. them., datë 04.02.2016, me objekt të padisë “*Njohje e vërtetësisë...*” i është caktuar gjyqtarit me short po në datën 04.02.2016 dhe ka përfunduar me vendimin nr.557 (1798), datë 03.05.2016. Referuar të dhënave rezulton se çështja ka përfunduar në një afat prej 2 muaj e 29 ditë, ***pra brenda afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (xi) Çështja civile nr.701 (21279-00188-51-16) regj. them., (*administruar për shkak të ankesave nga KPK*) me objekt të padisë “*Kthimin e kamatave ligjore për shkak të mosekzekutimit të vendimit...*” sipas të dhënave në vendim nr. 1517 (5441), rezulton se data e regjistrimit është 28.01.2016 dhe data e përfundimit të çështjes është 14.12.2016. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për një afat prej 10 muaj e 16 ditë, ***pra tej afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (xii) Çështja civile me nr.596 regjistrimi, datë regjistrimi 16.01.2014, (*e referuar nga Inspektorati i KLD për tu mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional*) me objekt “*Lirim dhe dorëzim sendi*”, përfunduar me vendimin nr. 1751 (5123), datë 15.12.2015, rezulton t’i jetë caktuar gjyqtarit me short në datën 10.03.2014. Gjykimi ka zgjatur për 1 vit, 9 muaj e 5 ditë, ***pra tej afati 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshje civile të karakterit të përgjithshëm.***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër analizohen edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së pasi 4 prej tyre janë gjykuar tej këtij afati, duke përbërë 36% të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 36% përkon me nivelin e vlerësimit 2 pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në kontekst sa më sipër arsyetohet u analizua kompleksiteti i çështjeve, i përcaktuar në Metodologji si një nga komponentët që mund të çojë në pikëzim më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore nga e cila rezultoi se:

1. Çështja që i përket vendimit civil nr.999 (3364), datë 21.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt të padisë “*Detyrim njohje pronar...*”. Referuar të dhënave rezulton se çështja i është caktuar gjyqtarit me short në datën 09.11.2015 dhe ka përfunduar në datën 21.07.2016, duke përfunduar brenda një afati prej 8 muajsh e 12 ditë, duke e tejkaluar standardit minimal kohor me 2 muaj e 12 ditë.

Lidhur me këtë çështje, KPK pasi i ka dëgjuar shpjegimet e gjyqtarit lidhur me shkaqet që kanë ndikuar në afatin e shqyrtimit të çështjes ka konkluduar se: “35.3 Trupi gjykues çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar shkaqet, të cilat kanë çuar në zgjatje të afateve të gjykimit të çështjes. Komisioni vlerëson se çështja e trajtuar nga subjekti ka rezultuar se ka qenë komplekse dhe me shumë palë ndërgjyqëse, duke mbajtur këtu në vëmendje detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër, e cila e kishte kthyer çështjen për rigjykim. Gjykata, në zbatim të nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, ka detyrimin që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin. Në zbatim të kësaj dispozite, gjatë hetimit gjyqësor, sikurse ka shpjeguar edhe subjekti, ka qenë i nevojshëm realizimi i një akti ekspertimi, si dhe kryerja e një akti shtesë ekspertimi, i cili ka krijuar shtyrje të seancave dhe zgjatje të afatit. 35.4 Gjykata, në zbatim të nenit 20 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit, duke u dhënë mundësi palëve të njihen me çdo provë në mënyrë efektive, si dhe të paraqesin pyetje dhe pretendime shtesë në lidhje me aktin e ekspertimit të ekspertëve, ku edhe këta hapa proceduralë kanë krijuar shtyrje të afatit. 35.5 Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk u evidentuan rrethana që përbëjnë shkelje procedurale të tilla, që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale”.

Nga të dhënat e dosjes rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë më 05.11.2015 dhe me shortin e datës 09.11.2015, ajo i është caktuar gjyqtarit {...}. Me vendim të datës 10.11.2015 (pas 1 dite) gjyqtari ka vendosur caktimin e seancës përgatitore në datën 22.12.2015, ora 11:00. Data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10 ditor të përcaktuar nga neni 155 i K.Pr.Civile. Nga të dhënat rezulton se janë 15 seanca të zhvilluara (2 seanca përgatitore dhe 13 seanca gjyqësore), nga të cilat vetëm 3 prej tyre nuk ka qenë efektive. Konkretisht, seancat gjyqësore të datave 28.01.2016 dhe 21.06.2016 nuk janë zhvilluar për mosformimit të trupit gjykues për arsye objektive dhe seanca e datës 17.02.2016 për mosparaqitje të Avokaturës së Shtetit. Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale. Rezulton, gjithashtu që seancat gjyqësore janë lënë në afate të afërta me njëra - tjetrën nga 6 ditë deri në 21 ditë. Gjithashtu, rezulton se gjatë gjykimit është pranuar për shqyrtim padia e ndërhyrësit kryesor, konform nenit 189 të K.Pr.Civile, si dhe rezulton që të jetë kryer akti i ekspertimit teknik me qëllim dhënien zgjidhje çështjeve teknike për zgjidhjen sa me drejtë të mosmarrëveshjes. Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti duhet të mbahet parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimit e gjyqtarit.

2. Çështja civile me nr. 73/965 (11115-00403-51-15) regj., datë 23.02.2015, me objekt të padisë “Lirim, dorëzim sendi”, përfunduar me vendimin nr. 565 (1815), datë 03.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Referuar të dhënave të vendimit konstatohet se çështja mban si datë regjistrimi 23.02.2015 dhe datë përfundimi 03.05.2016, gjykimi i kësaj çështje ka zgjatur për një afati prej 1 vit, 2 muaj e 10 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së. Afati tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është 8 muaj e 10 ditë, por këtu në ecjen e afatit të gjykimit të çështjes nuk duhet të përlllogaritet periudha e pushimeve vjetore (në muajin gusht 2015) e cila e rrit edhe me 1 muaj përfundimin e gjykimit të çështjes. Në këtë kontekst, nëse do të zbresim periudhën e mësipërme do të rezultonte që çështja do të kishte përfunduar nga ana

e gjyqtarit për një kohë prej 1 vit, 1 muaj e 10 ditë nga momenti i regjistrimit të kësaj çështje.

Në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit të kësaj çështjeje, KPK i ka kërkuar shpjegime gjyqtarit, i cili në shpjegimet e paraqitura argumenton se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes ka ardhur për shkaqe objektive dhe të arsyeshme, si dhe për një hetim të gjithanshëm të çështjes, duke parashtruar hapat proceduralë të ndjekur gjatë gjykimit:

- a) *seanca përgatitore është shtyrë për t'i dhënë kohë palës së paditur për të përgatitur mbrojtjen në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor;*
- b) *me kalimin e çështjes në seancë gjyqësore gjatë debatit mbi provat ka lindur nevoja që dokumentacioni i pronës së paditësit të merrej i rifreskuar pranë ish-ZRVPP Shkodër;*
- c) *5 seanca janë shtyrë, pasi ish-ZVRPP nuk depozitonte aktin e rifreskuar të pronësisë mbi pronën, ndonëse një gjë e tillë ishte urdhëruar nga gjykata;*
- d) *gjykata me kërkesë të palëve vendosi kryerjen e një akti ekspertimi teknik-topografik nga ekspert ing.gjeodet, i cili kërkoi minimumi 20 ditë kohë për të përfunduar aktin e ekspertimit;*
- e) *Seanca e radhës është shtyrë përsëri me kërkesë të ekspertit, për më shumë kohë për të përfunduar aktin e ekspertimit, pasi kishte hasur probleme gjatë këqyrjes në vend të pronës, pasi aty kishin pretendime edhe disa banorë të tjerë, posedues të kësaj prone, që nuk ishin palë në këtë gjykim;*
- f) *Kur u paraqit akti i ekspertimit, palët kërkuan kohë të njihen me aktin e ekspertimit dhe gjykata shtyu sërish seancën për një datë tjetër;*
- g) *Pasi palët u njohën me aktin dhe filloi debati mbi përmbajtjen e tij, prej tyre u konstatua se akti i ekspertimit nuk i kishte dhënë zgjidhje të gjitha detyrave të ngarkuara nga Gjykata dhe lindi nevoja për kryerjen e një akti ekspertimi shtesë prej ekspertit, i cili u bë shkak sërish për shtyrjen e seancës brenda një afati të përshtatshëm të kërkuar nga eksperti për aktin shtesë të ekspertimit;*
- h) *Me paraqitjen e aktit shtesë palët kërkuan kohë të njiheshin dhe të përgatisnin pyetjet mbi ekspertin dhe kundërshtimet e tyre mbi aktin;*
- i) *Pas përfundimit të debatit mbi provat, gjykata ka mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe ka shtyrë seancën, për t'u lënë kohë palëve të përgatisin bisedimet përfundimtare brenda afatit ligjor.*

Në përfundim, KPK ka arritur në konkluzionin se: *“Në rastin konkret konstatohet se çështja ka qenë komplekse, ka pasur vonesa për shkak të mosbashkëpunimit nga ana e ZVRPP-së Shkodër për të vënë në dispozicion dokumente të rifreskuara të pronës që po i nënshtruhej shqyrtimit gjyqësor dhe se procesi nuk është shtyrë për shkaqe të pajustificuara nga ana e subjektit të rivlerësimit. Rrethanat e mësipërme janë shkaqe të cilat kanë bërë që kjo çështje të mos përfundonte brenda afatit 6-mujor, parashikuar nga Aneksi I i sistemit të vlerësimit”. Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti duhet të mbahet parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimit e gjyqtarit.*

3. Çështja që i përket vendimit civil nr.883 (4421), datë 27.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me objekt të padisë *“Padi marrëdhënie pune”*. Referuar të dhënave rezulton se çështja është shortuar në datë 10.03.2014 dhe datë përfundimi 27.11.2014, duke përfunduar brenda një afati prej 8 muajsh e 17 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr.261/2 të KLD. Afati tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është 2 muaj e 23 ditë, por këtu duhet të mbahet në vëmendje edhe fakti se muaji gusht (30 ditë) përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve, e në këtë kontekst nuk duhet të përlogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar me 1 muaj e 23 ditë tej standardit. Nga të dhënat e dosjes rezulton se seanca përgatitore datë 27.03.2014, ora 09:30 është shtyrë për në datën 07.04.2014 me qëllim lënien kohë palës paditëse për të plotësuar të metat e padisë. Gjithashtu rezulton se njoftimi i të paditurit për seancën përgatitore dhe atë gjyqësore është realizuar nëpërmjet afishimit të shpalljes, i cili në zbatim të nenit 133 të K.Pr.Civile duhet të qëndrojë i afishuar për jo më pak se 20 ditë. Në këtë kontekst, nëse do të zbresim periudhën që gjykata i ka lënë palës paditëse për plotësimin e të metave

(11 ditë), si dhe periudhën për njoftimin e të paditurit nëpërmjet afishimit me shpallje publike (20 ditë njoftimin e seancës përgatitore dhe 20 njoftimi për seancën gjyqësore), do të rezultonte që çështja do të kishte përfunduar nga ana e gjyqtarit {...} për një kohë prej 5 muaj e 26 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 muajsh

4. Çështja civile nr.701 (21279-00188-51-16) regj. them., datë 28.01.2016 regjistrimi (administruar për shkak të ankesave nga KPK) me objekt të padisë “Kthimin e kamatave ligjore për shkak të mosekzekutimit të vendimit...” ka përfunduar me vendimin nr.1517 (5441), datë 14.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Referuar të dhënave të dosjes rezultoi se çështja është shortuar në datë 28.01.2016 dhe datë përfundimi 14.12.2016, duke përfunduar brenda një afati prej 10 muaj e 16 ditë, jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr.261/2 të KLD, me 4 muaj e 16 ditë tej afatit standard minimal kohor. Nga të dhënat e dosjes rezultoi se çështja është regjistruar në gjykatë më 28.01.2016 dhe po në të njëjtin datë, i është caktuar gjyqtarit {...}. Me vendim të datës 29.01.2016 (pas 1 dite) gjyqtari ka vendosur caktimin e seancës përgatitore në datën 23.02.2016, ora 12:00. Data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10 ditor të përcaktuar nga neni 155 i K.Pr.Civile. Nga të dhënat rezultoi se janë 15 seanca të zhvilluara (5 seanca përgatitore dhe 10 seanca gjyqësore), nga të cilat vetëm një prej tyre nuk ka qenë efektive. Konkretisht, seanca gjyqësore datë 24.11.2016 nuk është zhvilluar për mosformimit të trupit gjykues (pjesëmarrja në seminarin trajnues të Shkollës së Magjistraturës). Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: marrjen e provave të tretët, konform nenet 223 e 224 të K.Pr.Civile (për të cilën janë shtyrë 4 seanca gjyqësore, për të cilin gjyqtari bazuar në nenet 125 e 167 të K.Pr.Civile ka dënuar me gjobë institucionin përkatës); njoftimin e ekspertit të caktuar nga gjykata, lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit apo lënien kohë palëve për të përgatitur pretendimet përfundimtare. Rezultoi gjithashtu që seancat gjyqësore janë lënë në afate të arsyeshme me njëra - tjetrën nga 13 ditë deri në 1 muaj, me përjashtim të seancës së datës 13.09.2016, e cila është caktuar pas 55 ditësh, ku këtu ka ndikuar muaj gusht që përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve. Pra, ecuria procedurale, shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore, mënyra e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes, si dhe periudha e lejes vjetore e gjyqtarëve gjatë muajt gusht, duhet të mbahen parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimin e gjyqtarit.

5. Çështja civile me nr.596 regjistrimi, datë regjistrimi 16.01.2014, (e referuar nga Inspektorati i KLD për tu mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional) me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”, përfunduar me vendimin nr. 1751 (5123), datë 15.12.2015, rezultoi t’i jetë caktuar gjyqtarit me short në datën 10.03.2014. Gjykimi i kësaj çështje ka zgjatuar për një afat prej 1 vit, 9 muaj e 5 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së. Afati tejkallimit të çështjes nga standardi minimal kohor është 1 vit, 3 muaj e 5 ditë, por këtu në ecjen e afatit të gjykimit të çështjes nuk duhet të përlogariten periudhat e pushimeve vjetore (në muajin gusht 2014 dhe të viti 2015) të cilat e rrisin edhe me 2 muaj përfundimin e gjykimit të çështjes. Në këtë kontekst, nëse do të zbrisim periudhat e mësipërme do të rezultonte që çështja do të kishte përfunduar nga ana e gjyqtarit për një kohë prej 1 vit, 7 muaj e 5 ditë nga momenti i regjistrimit të kësaj çështje.

Pas verifikimit të ankesës nga ana e Inspektorëve të KLD-së rezultoi se çështja ka qenë tepër komplekse dhe me shumë palë ndërgjyqëse, konkretisht 29 të paditur, të cilët janë shtuar dhe pakësuar gjatë gjykimit nga vetë pala paditëse. Gjithashtu, rezultoi se gjatë gjykimit janë kryer dy akte ekspertimit, si dhe është paraqitur e shqyrtuar një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit, kërkesë e cila ka marrë kohë për shqyrtimin nga një gjyqtar tjetër. Po kështu, rezultoi që gjatë gjykimit është paraqitur edhe një kundërpadi, për të cilën është realizuar edhe një akt ekspertimit. Nga ana e inspektorëve është konkluduar se shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore kanë qenë ligjore dhe nuk konstatohen zvarritje të pajustificuara të procesit. I njëjti konkluzion është arritur edhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vendimin nr.719, datë 09.11.2023 ku konkludohet se gjykimi tej afateve të përcaktuara sipas rregullores ka qenë i arsyeshëm dhe jo për faj të keq menaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës logjike të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, lidhur me:

- (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar, që rezulton në masën 36%;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit, por që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, etj.;
- (iii) analizën jo vetëm matematikore, por edhe logjike të të dhënave statistikore, nga ka rezultuar jo vetëm gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, por edhe gjatë procesit të verifikimit të ankesës për njëri nga çështjet, si dhe gjatë analizës së të gjitha dosjeve burim vlerësimi, se zgjatja e gjykimeve, nuk ka ardhur për shkaqe që lidhen me mënyrën e menaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarit, por me nevojshmërinë e kryerjes së veprimeve procedurale;
- (iv) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësimit është me e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”;

pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues gjyqtari pikëzohet maksimalisht. Ky vlerësim bazohet në parimin e parashikuar nga neni 93, pika 2 e ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit aftësia e gjyqtarit lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve duhet të analizohet sipas situatës, duke shmangur përfundime për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Aftësia e gjyqtarit për respektimin e standardit minimal, nuk mund të barazohet vetëm me treguesin e shifrës apo të dhënës statistikore, pasi në rastin konkret ka qenë e mundur të analizohet çdo dosje gjyqësore, ku çështja ka përfunduar tej standardit minimal, analizë nga ka rezultuar që zgjatja ka ardhur për shkak kompleksiteti, sjellje të palëve, respektimit të të drejtave procedurale të palëve dhe nevojës për hetim gjyqësor të plotë e gjithëpërfshirës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i çështjeve jashtë standardit minimal, ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ((5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe 1 dosje të administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e Shkallës së Parë në periudhën e vlerësimit. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari, çështjes të administruar nga Komisioni për shkak të ankesave dhe çështjes të referuar për efekt vlerësimi nga ish-KLD, referuar kategorisë së çështjeve, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori, rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 12 çështje në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, rezulton të jetë rreth 7 muaj, *pra më e gjatë se standardi minimal kohor* prej 6 muaj për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm në gjykatën e shkallës së parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtarë”, rezulton të jetë rreth 2 muaj e 25 ditë, *pra më e shkurtër se standardin minimal kohor* prej 4 muajsh për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë rreth 26 ditë, *pra më e shkurtër se standardi minimal kohor* prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale krime në gjykatën e shkallës së parë.

KONKLuzioni

Referuar analizës matematikore si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, tejkalohe vetëm për një kategori (*civile me palë kundërshtarë*), si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtari lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti rivlerësimit {...}, ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit profesional se gjatë periudhës 08.10.2013-08.10.2016, i janë caktuar për gjykim gjithsej 1539 çështje, ku ka përfunduar 1611 çështje, duke mbartur vitin e fundit 82 çështje. **Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 104.6%.** Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtari {...}, ka përfunduar së gjykuari 1323 çështje. Nga ky total, 577 janë çështje civile të përgjithshme; 77 çështje janë familjare; 4 çështje administrative; 2 çështje tregtare; 59 çështje penale; 355 masa sigurimi; 493 penale administrative dhe 211 urdhra ekzekutimi. Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se gjyqtari {...}, gjatë periudhës 08.10.2013-08.10.2016, ka punuar edhe në dhomën civile seksioni i përgjithshëm, por edhe në dhomën penale. Gjyqtari ka shqyrtuar gjithashtu edhe kërkesa penale, masa sigurimi dhe kërkesa civile. Rezultoi se numri më i lartë i çështjeve të gjykuara nga gjyqtari {...}, i përkasin çështjeve civile (gjithsej 871 çështje me dhe pa palë kundërshtare). Si rezultat, për të vlerësuar nëse gjyqtari ka respektuar standardin sasior të përcaktuar në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, do të marrim në konsideratë gjykimet civile të themelit dhe me palë kundërshtare që përbëjnë dhe numrin më të lartë të gjykimeve të zhvilluara prej tij. Kështu, referuar nenit 3 gërma “e” të Aneksit 1, gjyqtari i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm, duhet të gjykojë jo më pak se 120 çështje në vit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare. Ndërkohë, rezultojnë se gjyqtari {...}, për 3 vitet e këtij vlerësimi profesional, ka përfunduar së gjykuari 660 çështje mosmarrëveshje civile me palë kundërshtare. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe ka tejkaluar me gati dyfishin standardin sasior sa i takon çështjeve civile me palë kundërshtare të gjykuara, pa llogaritur këtu edhe numrin e konsiderueshëm të çështjeve penale gjithsej 452 çështje të tilla të gjykuara nga ai gjyqtar”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultojnë se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtari {...} ka përfunduar 1323 çështje, nga të cilat 59 çështje penale themeli, 577 civile themeli, 77 çështje familjare, 4 çështje administrative, 2 çështje tregtare, 211 kërkesa civile (urdhër ekzekutimi), 37 kërkesa penale dhe 356 kërkesa në fazën e hetimit paraprak (masa sigurimi). Por sipas dosjes së rivlerësimit, gjyqtari ka filluar të ushtrojë detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në fund të muajit janar të vitit 2014. Kështu që të dhënat statistikore si më sipër i përkasin periudhës 24.01.2014-08.10.2016 (2 vjet e 9 muaj).

Referuar tabelave statistikore për periudhën 24.01.2014- 08.10.2016 rezultojnë të dhënat e mëposhtme për kategori çështjesh për çdo vit kalendarik :

- (iv) Viti 2014 (11 muaj): gjithsej 182 çështje themeli, ose rreth 65% më shumë se standardi i miratuar, duke llogaritur për periudhën 11 mujore;
- (v) Viti 2015: gjithsej 362 çështje themeli, ose rreth 201% më shumë se standardi i miratuar;
- (vi) Viti 2016 (10 muaj): gjithsej 175 çështje themeli, ose rreth 75% më shumë se standardi i miratuar duke llogaritur për periudhën 10 mujore.

Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “e” të vendimit të KLD, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë i dhomës civile, seksioni i përgjithshëm, si relator gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak se 120 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare, i llogaritur në periudhë 3 vjeçare jo më pak se 360 çështje themeli.

Referuar të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2014-08.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit rezulton se gjyqtari i janë caktuar në total 1539 çështje dhe ka përfunduar 1611 çështje, duke rezultuar kështu norma e likuidimit të çështjeve për gjithë periudhën e vlerësimit 104.6%.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 104.6%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 10 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, është konstatuar se gjyqtari {...}, ka respektuar afatin ligjor të dorëzimit të vendimit në të pesta dosjet e vëzhguara dhe të përzgjedhura me short. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 5), për 7 ditë nga shpallja (shih dosjen 4); për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen 3), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 2)dhe për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 1)”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10-ditor i ankimit ndaj vendimit penal dhe afati 10-ditor i arsyetimit të vendimit civil sipas parashikimeve të nenit 308/2 të K.Pr.Civile.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i) Çështja civile nr. 2010 (21236-02391-51-14) regj., datë regjistrimi 29.10.2014, me objekt të padisë *“Detyrimin e palës së paditur t’i japë pension pleqërie..”*, e përfunduar me vendimin nr.1518 (4403), datë 26.11.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 01.12.2014, pra 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (ii) Çështja civile nr. 783 (21282-00370-51-14) regj., datë regjistrimi 20.02.2014, me objekt të padisë *“Pavlefshmëri të titullit ekzekutiv”*, e përfunduar me vendimin nr.6365 (955), datë 17.03.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 21.03.2014, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (iii) Çështja civile nr. 21290-00695-51-2015 (5115) regj., datë regjistrimi 02.04.2015, me objekt të padisë *“Anulim gjobe”*, e përfunduar me vendimin nr.1497 (4298), datë 29.10.2015. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 03.11.2015, pra 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (iv) Çështja civile nr. 11111-02317-51-2015 regj., datë regjistrimi 09.11.2015, me objekt të padisë *“Detyrim njohje pronar...”*, e përfunduar me vendimin nr.999 (3364), datë 21.07.2016. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 28.07.2016, pra 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (v) Kërkesa penale nr. 61001-02043-51-2014 regj., datë regjistrimi 02.12.2014, me objekt *“Lejim kontroll banese”*, e përfunduar me vendimin nr.948 (4501), datë 03.12.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 05.12.2014, pra 2 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të

K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

- (vi) Çështja civile nr. 719 (21256-00280-51-14) regj., datë regjistrimi 10.02.2014, me objekt të padisë “*Pushim cenimi në pronësi*”, e përfunduar me vendimin nr.1076 (2842), datë 23.07.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 31.07.2014, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (vii) Çështja civile nr. 883 (21264-00532-51-14) regj., datë regjistrimi 10.03.2014, me objekt të padisë “*Dëmshpërblim që rrjedh nga marrëdhënia e punës*”, e përfunduar me vendimin nr.1528 (4421), datë 27.11.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 05.12.2014, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (viii) Çështja civile nr. 1218 (0775) regj., datë regjistrimi 14.04.2015, me objekt të padisë “*Zgjidhje martese*”, e përfunduar me vendimin nr.1056 (2782), datë 01.07.2015. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 03.07.2015, pra 2 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (ix) Çështja civile nr. 167/1789 (11217-02031-51-14) regj., datë regjistrimi 21.09.2014, me objekt të padisë “*Përbushje e detyrimit kontraktual...*”, e përfunduar me vendimin nr.135 (314), datë 27.01.2015. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 06.02.2015, pra 10 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (x) Çështja penale nr.723 (58345-00969-51-16) regj., datë regjistrimi 27.04.2016, me të pandehur M.R., akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt*”, e përfunduar me vendimin nr.526 (2213), datë 24.05.2016. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 26.05.2016, pra 2 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (xi) Çështja civile nr. 743 (11232-00249-51-16) regj., datë regjistrimi 04.02.2016, me objekt të padisë “*Njohjen e mbiemrit...*”, e përfunduar me vendimin nr.557 (1798), datë 03.05.2016. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 09.05.2016, pra 6 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

Referuar çështjeve sipas kategorive të tyre, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar

- (i) për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 7 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (ii) për kategorinë “Çështje familjare me palë kundërshtare”, është 2 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (iii) për kategorinë “Çështje penale-krime”, është 6 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor;
- (iv) për kategorinë “Kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”, është 2 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar rezulton “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është “Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JOPRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe dosja e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e shortuara, por edhe në 3 dosjet që i përkasin dokumenteve 1 e 3 të përzgjedhur nga vet subjekti i rivlerësimit (më hollësisht shih analizën e dosjeve (1-5). Katër nga pesë gjykimet e vëzhguara nga ana jonë, kanë përfunduar në respektim të afateve standarde të caktuara nga Sistemi i Vlerësimit, apo në respektim të afatit ligjor. Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjet 1 e 5); me 15 seanca (shih dosjen 4); me 10 seanca (shih dosjen 3) dhe me 5 seanca (shih dosjen 2). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 32 seanca gjyqësore, nga të cilat 10 seanca nuk kanë qenë produktive. Dhjetë seancat joproduktive i hasëm në gjykimet që ju përkasin dosjeve 2, 3 dhe 4, të gjitha gjykime themeli dhe me palë kundërshtare. Në dosjen civile nr. 2, gjykim themeli me palë kundërshtare, nga pesë seanca të zhvilluara vetëm njëra dështoi, shkak ishte moskryerja e njoftimit nga shërbimi postar. Pra dështimi i seancës nuk ishte për faj të gjyqtarit. Në dosjen civile me nr. 3, nga 10 seanca të ezauruara pesë prej tyre dështuan. Pesë seanca dështuan për shkak të mungesave të palëve, ku në katër seanca mungoi pala e paditur dhe në një seancë mungoi pala paditëse (shih seancat 3, 5, 6, 7 dhe 8 të dosjes nr. 3). Pesë seancat e tjera u zhvilluan normalisht. Vet gjyqtari ishte i pranishëm në çdo seancë dhe nuk konstatohet shtyrje e pajustificuar e ndonjë seance. Afati, distanca kohore midis seancave vlerësohet e arsyeshme. Në dosjen civile nr. 4, gjykim themeli e me palë kundërshtare, nga 15 seanca të ezauruara, 4 seanca dështuan. Dy seanca dështuan për mosparaqitje të gjyqtarit për shkaqe të arsyeshme. Në një seancë gjyqtari nuk mori pjesë pasi ishte deleguar nga KLD-ja për të gjykuar një çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, ndërsa në një seancë tjetër gjyqtari mori pjesë në një seminar i ftuar nga Shkolla e*

Magjistraturës. Pjesëmarrja e gjyqtarëve në seminaret e Shkollës së Magjistraturës ndikon d.p.drejti në vlerësimin e tyre profesional. Një seancë dështoi për shkak se nuk kishte konfirmim për Avokaturën e Shtetit, faji në këtë rast i faturohet Shërbimit Postar. Seanca e pestë dështoi për shkak se Avokatura e Shtetit kërkoi kohë për tu njohur me provat e dosjes para se të paraqiste qëndrimin e saj. Planifikimi i seancave nga njëra-tjetra është bërë në një distancë optimale, ndërkohë nuk konstatohet shtyrje e pajustificuar e ndonjë seance...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, pasi dosja me nr.5 i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- (i) Dosja 1 - që i përket çështjes civile, me nr.2010 (21236-02391-51-14) regjistri, datë regjistrimi 29.10.2014, përfunduar me vendimin nr.1518 (4403), datë 26.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk rezulton që jenë zhvilluar seanca gjyqësore, pasi çështja ka përfunduar me vendim jopërfundimtar të dhënë në seancë përgatitore, duke disponuar për moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes.
- (ii) Dosja 2 - që i përket çështjes civile, me nr.783 (21282-00370-51-14) regjistri, datë regjistrimi 20.02.2014, përfunduar me vendimin nr.6365 (955), datë 17.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive. Seanca gjyqësore është shtyrë për shkaqe procedurale, lënien kohë palëve për të përgatitur diskutimet përfundimtare.
- (iii) Dosja 3 - që i përket çështjes civile, me nr.21290-00695-51-2015 (5115) regjistri, datë regjistrimi 02.04.2015, përfunduar me vendimin nr.1497 (4298), datë 29.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 9 seanca gjyqësore, nga të cilat 5 seanca kanë rezultuar joproductive, për shkak të mosparaqitjes së palës së paditur apo përfaqësuesit të palës paditëse. Seancat e tjera gjyqësore janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: lënien kohë palës së paditur për të përgatitur prapësimet me shkrim, lënien kohë për të paraqitur prova të reja dhe lënien kohë për pretendimet përfundimtare.
- (iv) Dosja 4 – që i përket çështjes civile, me nr.11111-02317-51-2015 regjistri, datë regjistrimi 09.11.2015, përfunduar me vendimin nr.999 (3364), datë 21.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 13 seanca gjyqësore, nga të cilat 3 seanca kanë rezultuar joproductive, për shkak të mosformimit të trupit gjykues, mosparaqitjes së Avokaturës së Shtetit. Seancat e tjera gjyqësore janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: lënien kohë avokaturës së shtetit për të paraqitur qëndrimin e saj lidhur me padinë, për të njoftuar ekspertin e caktuar nga gjykata, lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit, lënien kohe palëve për tu njohur me aktin e ekspertimit dhe lënien kohë për pretendimet përfundimtare.
- (v) Dosja 6 - që i përket çështjes civile, me nr.719 (21256-00280-51-14) regjistri, datë regjistrimi 10.02.2014, përfunduar me vendimin nr.1076 (2842), datë 23.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive. Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit, lënien kohë palëve për tu njohur me aktin, si dhe lënien kohë për të përgatitur pretendimet përfundimtare.
- (vi) Dosja 7 - që i përket çështjes civile, me nr.883 (21264-00532-51-14) regjistri, datë regjistrimi 10.03.2014, përfunduar me vendimin nr.1528 (4421), datë 27.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore, nga të cilat 2 seanca kanë rezultuar joproductive, për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të palës

paditëse dhe mosrealizimit të afishimit të shpalljes nga njësi administrative lidhur me njoftimin e palës së paditur.

- (vii) Dosja 8 - që i përket çështjes familjare, me nr.1218 (0775) regjistri, datë regjistrimi 14.04.2015, përfunduar me vendimin nr.1056 (2782), datë 01.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 seanca gjyqësore, nga të cilat 1 seancë ka rezultuar joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së ekspertës psikologe. Seancat e tjera e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimin e ekspertës të caktuar nga gjykata në lidhje me kërkimin për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, lënien kohë ekspertës për të përgatitur aktin e ekspertimit.
- (viii) Dosja 9 - që i përket çështjes civile me nr.167/1789 (11217-02031-51-14) regjistri, datë regjistrimi 21.09.2014, ka përfunduar me vendimin nr.135 (314), datë 27.01.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 seanca gjyqësore, nga të cilat 1 ka rezultuar joproduktive, për shkak të mosrealizimit të njoftimit për palën e paditur.
- (ix) Dosja 10 - që i përket çështjes penale me nr.723 (58345-00969-51-16) regjistri, datë regjistrimi 27.04.2016, ka përfunduar me vendimin nr.526 (2213), datë 24.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 2 seanca gjyqësore, të cilat kanë rezultuar produktive.
- (x) Dosja 11 - që i përket çështjes civile me nr.743 (11232-00249-51-16) regjistri, datë regjistrimi 04.02.2016, ka përfunduar me vendimin nr.557 (1798), datë 03.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimin e mbrojtësit të zgjedhur prej të pandehurit apo lënien kohë palëve për përgatitjen e diskutimeve përfundimtare me shkrim.

Nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara, varion nga 0⁴⁸ deri në 13 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 4 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” (duke përjashtuar seancat përgatitore), 2 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “*Penale themeli*” dhe 4 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “*Familjare me palë kundërshtare*” (duke përjashtuar seanca e pajtimit).

Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 10 çështjet me palë kundërshtare të analizuar, rezulton të jetë 4 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile, familjare dhe penale themeli) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile, nenin 202 të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Në çështjen penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Konstatohet nga aktet në dosjeve burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore, në referim të nenit 158/a të K.Pr.Civile dhe

⁴⁸Shih dosjen me nr.1518 (4403), datë 26.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, në referim të nenit 333 të K.Pr.Penale, dhe duke pasqyruar në këto akte në mënyrë të qartë urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile apo K.Pr.Penale.

Seancat gjyqësore rezultojnë se janë shtyrë për shkaqe të përligjura dhe kryesisht për marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për gjykimin nga të tretët; për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj për shkaqe të përligjura; për të mundësuar njoftimin dhe pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit; për të paraqitur prova në dobi të gjykimit; për njoftimin e ekspertit të caktuar nga gjykata; për përgatitjen e aktit të ekspertimit; për mosparaqitjen e ekspertit; për njoftimin e kërkesës për ndryshimin e objektit të padisë palëve në mungesë; me kërkesë të palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, etj.

Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale. Po kështu edhe në çështjet civile konstatohet respektimi i afatit procedural 5 ditor kur seanca është shtyrë për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 305 të K.Pr.Civile. Nga të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara, në dy rast seanca nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye objektive (*shih dosjen që i përket vendimit nr.999 (3364), datë 21.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*).

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3, gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, sepse ai ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe dosja e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e shortuara, por edhe në 3 dosjet që i përkasin dokumenteve 1 e 3 të përzgjedhur nga vet subjekti i rivlerësimit (më hollësisht shih analizën e dosjeve (1-5)...Planifikimi i seancave nga njëra-tjetra është bërë në një distancë optimale, ndërkohë nuk konstatohet shtyrje e pajustificuar e ndonjë seance. Seancat gjyqësore përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por hasen edhe raste kur seancat kanë filluar me vonesë dhe në procesverbalin gjyqësor gjyqtari është kujdesur të pasqyrojë shkakun e vonesës. Nuk është konstatuar që fillimi i seancës me vonesë të ketë ndikuar në mbarëvajtjen e gjykimit. Në dosjet nr.3 dhe nr. 4, është konstatuar se një pjesë e seancave gjyqësore janë regjistruar në audio. Gjyqtari është përpjekur të zhvillojë seancat gjyqësore me sistem audio, pavarësisht mundësive të pakta që ka Gjykata e Rrethit Shkodër për zhvillimin e seancave audio, për shkak të numrit të pakët të sallave të gjyqit. Përgjithësisht nga të dhënat e mësipërme mund të themi që gjyqtari {...}, i ka kushtuar vëmendje respektimit të procedurës dhe transparencës së gjykimit”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 8 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve civile me palë kundërshtare, 1 kategorisë penale themeli, 1 kategorisë çështje familjare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore/pajtimit/gjyqësore menjëherë⁴⁹ ose deri në 6 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin

⁴⁹Shih dosjen që i përket vendimit nr.948 (4501), datë 03.12.2014

e seancës gjyqësore, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Shkak i mos zhvillimit të të gjitha seancave gjyqësore me sistemin audio ka qenë për arsye administrative dhe funksionaliteti në gjykatën pranë se cilës ka ushtruar funksionin gjyqtari në periudhën e vlerësimit (*për shkak të pamundësisë së zhvillimit të seancës gjyqësore në sallë*). Pavarësisht këtij shkak, seancat të cilat nuk janë zhvilluar me sistemin audio, janë dokumentuar me procesverbal gjyqësor me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Në çështjet civile- seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijëni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në çështjen penale- Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal sipas parashikimeve të neneve 405 e vijues të K.Pr.Penale (në rastet kur është proceduar me gjykim të shkurtuar). Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, apo prezencën e familjarit për të pandehurin e mitur, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar. Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohet se në disa raste (11 seanca) seanca ka filluar me më shumë se 18 minuta deri në 2 orë e 29 minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në tërësi, pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuar (*29% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë*) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkak i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relatimit të gjyqtarit lidhet me pjesëmarrjen e tij në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, në pritje të

paraqitjes së prokurorit, apo edhe në pritje të zhvillimit të seancës gjyqësore me sistemin audio duke qenë se sallat e gjykimit kanë qenë të zëna me gjykime të tjera.

KONKLZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, përgjithësisht duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe dosja e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short për gjyqtarin {...}, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjen penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, diskutimet me shkrim të

palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe dosja e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Gjyqtari pasi merr dosjen për shqyrtim, disponon me vendim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore sipas rastit. Në dosjet civile, përgjithësisht gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpatria, fleta e shortit, vendimi i gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, fletëthirrjet për palët, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, provat, vendimi përfundimtar, ankimi në rast se ka patur, procesverbali dhe vendimi i gjykatës përkatëse të apelit, etj. Gjithashtu në gjykimet që i përkasin dosjeve penale (vetëm një dosje penale e gjykuar), gjenden: kërkesa për gjykim bashkë me fashikullin hetimor, vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, fletëthirrjet, provat, procesverbali i

seancës gjyqësore, vendimi përfundimtar, etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara përgjithësisht ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (vendimi për caktimin e seancës së pajtimit/përgatitore/gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbali i seancës përgatitore apo gjyqësore, vendimi përfundimtar), si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, autorizime, padia dhe provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, parashtrimet me shkrim dhe diskutimet përfundimtare të palëve).

Thuhet “përgjithësisht”, pasi në çështjen familjare të përfunduar me vendimin nr.1056 (2782), datë 01.07.2015 evidentohet se mungon procesverbali i seancës së pajtimit datë 15.05.2015. Referuar të dhënave procedurale të cituara në arsyetimin e vendimit rezulton se gjatë gjykimit nga ana e gjykatës është zhvilluar seanca e pajtimit, por në dosje mungon dokumentit i këtij veprimi.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtari parashtroi kundërshtimet e tij, duke u shprehur se “Lidhur me faktin e mungesës të procesverbalit të seancës së pajtimit në çështjen me objekt zgjidhje martese (sikurse ka evidentuar edhe Projektraporti), sqaroj se: Dosja nr. 8 që i përket çështjes civile me nr. regjistri 1218 (0775), datë regjistrimi 14.04.2015, me palë paditese B.M., palë e paditur G.N., me objekt “Zgjidhje martese”, ka përfunduar prej meje me vendimin nr.1056 (2782), datë 01.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Çështja është shortuar në datën 14.04.2015 dhe me shortin e po kësaj dite më është caktuar mua, gjyqtarit {...}. Me vendimin e datës 17.04.2015 (3 ditë pas caktimit) çështja është vënë në lëvizje prej meje gjyqtarit duke caktuar fillimisht seancën e pajtimit më datë 13.05.2015, në përputhje me parashikimet e nenit 182 të K.Pr.Civile dhe nenit 134 të Kodit të Familjes, duke urdhëruar paraqitjen personalisht të bashkëshortëve palë ndërgjyqëse, si dhe njoftimin e vendimit palëve dhe përfaqësuesve të tyre. Referuar të dhënave procedurale të cituara në procesverbalin e seancës së pajtimit datë 13.05.2015 rezulton se prej palëve është paraqitur vetëm paditësja B.M ndërsa i paditur G.N nuk ishte paraqitur personalisht por ishin paraqitur dy prindërit e tij N.N dhe L.N të cilët kanë deklaruar se djali i tyre ka patur dijeni për datën dhe orën por nuk mund të paraqitej. Në këto kushte, me kërkesë edhe të palës paditëse rezulton se seanca e pajtimit është shtyrë për më datë 15.05.2015 ora 08:45 dhe njoftimin për të paditurin e G.N e kanë marrë përsipër prindërit e tij N.N dhe L.N. Në vijim të veprimeve, në dosje nuk rezulton të jetë administruar procesverbali i seancës së pajtimit datë 15.05.2015, ora 08:45, por rezulton se menjëherë në po të njëjtën datë 15.05.2015 ora 09:00 është zhvilluar në vijim seanca gjyqësore për zgjidhjen në themel (mbajtur procesverbali përkatës). Pavarësisht kësaj, referuar të dhënave procedurale të cituara në procesverbalin e pajtimit datë 13.05.2015 dhe procesverbalin e seancës gjyqësore datë 15.05.2015 ora 09.00, njëkohësisht edhe atyre të cituara në arsyetimin e vendimit nr.1056 (2782), datë 01.07.2015, të cilat përputhen dhe janë në harmoni logjike me njëra tjetrën, rezulton e qartë që të jetë zhvilluar seanca e pajtimit datë 15.05.2015, ora 08:45. Një detaj tjetër që tregon se është zhvilluar dhe

dokumentuar seanca e pajtimit datë 15.05.2015 ora 08:45, është fakti se procesverbali i seancës së pajtimit e datës 13.05.2015 është dy fletë, ku fillon me faqen 1 dhe mbaron në faqen 2, ndërsa seanca gjyqësore e datës 15.05.2015 ora 09:00 fillon në faqen nr. 6 çka tregon se mungojnë 3 fletë të procesverbalit të seancës së dytë të pajtimit 15.05.2015 ora 08:45 pa u lidhur ne dosje. Sa më sipër, rezulton se seanca e dytë e pajtimit është zhvilluar dhe dokumentuar përmes procesverbalit përkatës dhe nga verifikimet e kryera prej meje në përfundim të gjykimit rezulton të ketë qenë në dosje. Ndërkohë, mungesa e administrimit të këtij akti procedural në dosjen civile ka ardhur për shkak të pakujdesisë së sekretares gjyqësore, pasi nga ana ime i është dorëzuar dosja gjyqësore për lidhjen e akteve, veprim ky i cili është detyrë e sekretareve gjyqësore referuar “Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Gjyqësore” (Miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.1830, datë 3.4.2001) neni 21 ku parashikohet se është detyra e sekretarit të seancës gjyqësore të lidh në mënyrë kronologjike dokumentacionin, sipas kohës së paraqitjes dhe aktet procedurale, sipas kohës së krijimit në dosjen gjyqësore. Pra, procesverbali i seancës së pajtimit datë 15.05.2015 ora 08:45 është mbajtur dhe është nënshkruar nga ana ime si gjyqtar dhe është verifikuar, përpara se t’ia kaloja dosjen sekretares gjyqësore për lidhjen e akteve. Ndërkohë, në vijim, nga ana ime në cilësinë e gjyqtarit, nuk janë kryer më verifikime të mëtejshme me bindjen se dosja ishte verifikuar dhe në të nuk kishte mangësi dokumentacioni/aktesh, njëkohësisht edhe për faktin se nga ngarkesa shumë e madhe në këto vite pune (çka duket qartë nga statistikat) e kam patur të pamundur objektivisht për të rikontrolluar qepjen e çdo dosjeje nga sekretaria gjyqësore pas dorëzimit të saj tek kjo e fundit. Në koherencë me sa më sipër, dua t’ju bëj me dije edhe një fakt tjetër që përforcon atë çka kam sqaruar më sipër në lidhje me faktin se mungesa e administrimit ka ardhur për faj të sekretares gjyqësore. Konkretisht, rezulton se për të njëjtën sekretare gjyqësore janë evidentuar edhe problematika (mangësi) të tjera me lidhjen e akteve në dosje gjyqësore (si p.sh procesverbale të disa seancave apo akteve të tjera në vitet 2014-2015) dhe për këtë shkak ndaj saj mbi bazën e kallëzimit të palës ndërgjyqëse Gj.Shkambi ka nisur edhe një procedim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Shkodër me nr.88 procedimi, viti 2022, i cili nuk ka përfunduar ende me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

KONKLUZIONI

Referuar burimeve të vlerësimit, në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete. Vetëm mungesa e një procesverbali të seancës së pajtimit në çështjen e analizuar, vlerësohet një rast i izoluar dhe që lidhet me specifikën e përmendur nga gjyqtari në kundërshtimet e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...} (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLGJ-së). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”.*

Nga aktet e dosjes së rivlerësimit, rezulton se në të nuk janë administruar aktet lidhur me verifikimin e ankesave. Për këtë arsye, u administruan nga arkiva e KLGJ, aktet përkatëse për verifikimin e secilës ankesë. Në relacionin e hartuar nga Inspektorati i KLD, trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij raporti, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore. Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 719, datë 09.11.2023, rezulton se KPK nuk ka evidentuar dhe as ka shqyrtuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” shkalla e aftësisë së gjyqtarit është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...}, si dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjatë periudhës 08.10.2013-08.10.2016, në adresë të gjyqtarit {...}, në ish-Inspektoratin e KLD-së, nuk është depozituar asnjë ankesë në lidhje me integritetin e tij”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin janë paraqitur 4 ankesë në Inspektoratin e ish KLD.⁵⁰ Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së me nr.719, datë 09.11.2023 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me etikën, kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, ka konkluduar si vijon: “...29.1 Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, çmon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr.84/2016, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka

⁵⁰Sikurse pasqyrohet në pjesën e dytë të këtij raporti, të titulluar “Burimet e vlerësimit”

arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë..... 30.4 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit {...} arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe e ka plotësuar saktë atë...”.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë nën kriter, konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për gjyqtarit {...} në asnjë nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese, apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe dosja e administruar për shkak të ankesave);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: “Për gjyqtarit {...} në asnjë nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), evidentohet se në çështjen civile me nr.596 regjistrimi, datë regjistrimi 16.01.2014, (trajtuar në relacionin e datës 22.12.2015) me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”, përfunduar me vendimin nr. 1751 (5123), datë

15.12.2015, gjatë shqyrtimit të çështjes nga pala e paditur është paraqitur një kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit. Në relacionin e KLD nuk ka të dhëna lidhur me vendimin për kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, por në kushtet kur gjykimi ka vijuar me të njëjtin trup gjykues, presumohet se kjo kërkesë nuk është pranuar.

Nga ana tjetër, nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, rezulton se nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se: “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor, por edhe në diskun që pasqyrojnë regjistrimin e seancave në audio është konstatuar se gjyqtari {...}, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore apo edhe në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe dosja e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre dhe në çdo rast duke respektuar normat e komunikimit zyrtar dhe etik.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e provave nga të tretët, etj.*) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe dosja e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se: *“Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarit {...}, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk konstatohen vonesa nga gjyqtari në arsyetimin e dorëzimit të vendimeve në sekretarinë gjyqësore apo problematika në përmbajtjen e procesverbaleve gjyqësore, gjë që tregon një bashkëpunim korrekt të tij me administratën gjyqësore. Nga analiza e pesë dosjeve të shortuara, nuk hasen problematika në bashkëpunimin e subjektit të rivlerësimit me stafin administrativ të gjykatës”.*

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimit: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi, si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës

gjqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social etj., vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHduES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 17 (shtatëmbëdhjetë) seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat tek Trajnimet në 3 Vitet e Fundit). Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 31 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkollës së parë. Pra, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit z. {...}, i ka kushtuar vëmendje të shtuar thellimit të njohurive profesionale nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në shumë trajnime të organizuara prej Shkollës së Magjistraturës”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 1103 prot., datë 31.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit në 17 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 30 ditë trajnimi.⁵¹

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile dhe procedurale civile, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 30 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M është brenda kufijve ligjore 15-120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

⁵¹Në trajnimin me temë “Aspekte procedurale të padisë...” të zhvilluar në datat 28-29 janar 2015, gjyqtari ka marrë pjesë vetëm ditën e dytë

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËRINSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, si dhe akteve të dorëzuara nga gjyqtari rezulton angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale, të kontributit në pjesëmarrje në aktivitete të edukimit të komunitetit.

Konkretisht, gjyqtari nëpërmjet postës elektronike, në datën 07.05.2024, paraqit vërtetimin me nr.130 prot., datë 07.05.2024 të Universitetit “Luarasi”, sipas të cilit z.{...} në datën 21.04.2015 ka qenë i ftuar si lektor pranë auditorit të Fakulteti të Drejtësisë të Universitetit për të kryesuar tavolinën e rrumbullakët me temë “Detyrimet jashtëkontraktore në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare private”, me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:*

Në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nga aktet e dorëzuara nga gjyqtari bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit profesional, nuk evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016 gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë të dhëna dhe për këtë ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	93

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIM**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR